



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

01.07.2017  
Prishtinë

## **Komunikatë**

Më qëllim të informimit të drejtë të opinionit ju njoftojmë se sot me datën 01.07.2017 në portalin e Express-it, është publikuar lajmi “**PZAP fillon hetimin për 24 ankesa, refuzon 41 të tjera**” i cili është marr nga KosovaPress.

Titulli i lajmit në fjalë është keq interpretuar nga portali dhe nuk përputhet me deklaratën e dhënë nga Z. Mulë Desku, Kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it.

PZAP-i sot ka filluar dhe zhvilluar hetimet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve të KQZ-së për 24 raste për të cilat ka vlerësuar. Por në procedurë të shqyrtimit janë edhe 41 ankesa për të cilat do të vendoset brenda afatit të paraparë me ligj.

**Ju Faleminderit**